

VENDIM
Nr. 246, datë 29.9.2022

**MBI KËRKESËN E OST SHA “PËR ZGJATJEN E PERIUDHËS SË PARASHIKUAR
NË PIKËN 2 TË VENDIMIT TË ERE-s NR. 78, DATË 13.4.2022”**

Në mbështetje të nenit 16, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; si dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.9.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Inspektiveve, me nr. 1625 prot., datë 21.09.2022, “Mbi kërkesën e OST sh.a. për zgjatjen e periudhës së parashikuar në pikën 2 të vendimit të ERE-s nr. 78, datë 13.4.2022”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 106, datë 2.7.2020, miratoi “Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike”. Në vijim me vendim e Bordit të ERE-s nr. 78, datë 13.4.2022, “Mbi rregullat e tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin nr. 106, datë 2.7.2020”, ndër të tjera në pikën 2 të vendimit, përcaktohet, se:

- *“Deri më 30 shtator 2022, periudha kohore e proceseve në të cilat përfshihen edhe nominimet dhe llogaritjet respektive të disbalancave të kryhet me interval kohor prej 1 orë”.*

- Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., me shkresën nr. 5359 prot., datë 2.9.2022, parashtron se: Komiteti përgjegjës i ngritur për rishikimin e Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike, të miratuara me vendimin e ERE-s nr. 106, datë 2.7.2020 është në proces vlerësimi të gjithë skenarëve, me qëllim që të kemi një rishikim gjithëpërfshirës të rregullave. Pjesë përbërëse e procedurës është dhe rishikimi i intervalit kohor prej 15 minutash në proceset e tregut të balancimit, ku përfshihen nominimet, llogaritjet respektive të disbalancave dhe selektimi i rezolucioneve kohore të konfigurimit të proceseve. OST sh.a. vlerëson se nevojitet një periudhë më e gjatë për ta finalizuar këtë proces të rëndësishëm për operimin e tregut balancues duke kërkuar zgjatjen e periudhës së parashikuar në pikën 2 të vendimit të ERE-s nr. 78, datë 13.4.2022, deri në datën 31 dhjetor 2022.

- Duke marrë në konsideratë këtë kërkesë të OST sh.a. dhe duke pasur parasysh faktin e rëndësishëm të tregut të balancimit të energjisë elektrike, ERE me urdhrin nr. 112, datë 13.9.2022, zhvilloi një seancë dëgjimore në datë 20.9.2022, me përfaqësuesit e OST sh.a. ku u kërkuar një informacion më i detajuar për ecurinë e implementimit të ndryshimeve në platformën elektronike (DAMAS), pasi OST sh.a. sikurse evidentuar në konstatimet e vendimit të ERE-s nr. 78, datë 13.4.2022, nëpërmjet shkresës nr. 1892 prot., datë 23.3.2022, protokolluar në ERE me nr. 400 prot., datë 24.3.2022, ka evidentuar faktin se në kushtet e shpalljes së gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike, në zbatim të VKM-së nr. 584, datë 8.10.2021, OST sh.a. ka qenë e detyruar të pezullojë investimet e parashikuara për vitin 2021, duke krijuar po ashtu dhe ngadalësim të procesit të implementimit në platformën elektronike DAMAS të specifikimeve që reflektojnë përmbushjen e parashikimeve të “Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 2.7.2020”.

- ERE vëren se OST sh.a. përgjatë periudhës kohore nga 1 prilli 2021, momenti kur ka filluar operimi i tregut të balancimit të energjisë elektrike bazuar në “Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106/2020”, nuk ka aplikuar rezolucionin 15 minutësh, si periudhë kohore e proceseve ku përfshihen edhe nominimet dhe llogaritjet respektive të disbalancave, për intervalin kohor prej 1 orë.

- Përgjatë kësaj periudhe kohore të operimit të tregut të balancimit të energjisë elektrike në raportimet periodike të bëra nga OST sh.a. nuk evidentohet ndonjë problematikë në tregun e balancimit që të lidhet me intervalin kohor prej 1 ore në të cilin realizohen proceset ku përfshihen nominimet dhe llogaritjet respektive të disbalancave në treg. Pjesëtarët e tjerë të tregut të energjisë elektrike të cilët operojnë në tregun e balancimit nuk kanë përcjellë në ERE përgjatë kësaj periudhe

kohore shqetësime apo problematika që lidhen me intervalin kohor prej 1 ore në të cilin realizohen proceset ku përfshihen nominimet dhe llogaritjet respektive të disbalancave në treg.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 108, datë 22.4.2021, ka miratuar “Rregullat e përbashkëta të shlyerjes për shkëmbimin e energjisë në përputhje me nenet 50(3) dhe 51(1), të Komisionit Rregullator të Bashkimit Evropian 2017/2195”. Këto rregulla aplikohen nga OST-të e Evropës kontinentale anëtare të ENTSO-E, që nga data 1 qershor 2021. Aktualisht për OST sh.a. aplikimi i këtyre rregullave është duke u realizuar me intervalin kohor prej 1 ore. Në këtë kontekst aplikimi i intervalit kohor prej 1 ore në tregun e brendshëm të balancimit të energjisë elektrike nuk sjell asnjë pasojë për këtë mekanizëm, përkundrazi aplikimi i afatit kohor prej 1 ore edhe në tregun e brendshëm të balancimit ndikon në harmonizimin e këtyre proceseve.

- OST sh.a. është në proces të implementimit në platformën elektronike të menaxhimit të tregut, të specifikimeve të hartuara konform rregullave në fuqi në të cilat përfshihen dhe kërkesat që lindin si pasojë e diversifikimit të burimeve të rinovueshme dhe integrimi i tyre në tregun balancues. Si dhe implementimi i procesit Imbalance Netting me vendet fqinje në mënyrë të tillë për minimizimin e kostove të disbalancave në interkonjeksion.

- ERE vlerëson të arsyeshme kërkesën e OST sh.a., për zgjatjen e periudhës së parashikuar në pikën 2 të vendimit të ERE-s nr. 78, datë 13.4.2022, deri në datën 31 mars 2023, meqenëse Bursa Shqiptare e Energjisë aktualisht është licencuar në ERE dhe në vijim do të ndiqen proceset që lidhen me operimin e saj dhe të tregut të balancimit, si dhe me qëllim që gjatë kësaj kohe të implementohen ndryshimet në platformën IT të OST sh.a. nga kontraktori i përzgjedhur, si dhe të realizohet harmonizimi i proceseve IT me Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike të miratuara me vendimin e të ERE-s nr. 106, datë 2.7.2020”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës së OST sh.a., për zgjatjen e periudhës së parashikuar në pikën 2 të vendimit të ERE-s nr. 78, datë 13.4.2022.

2. Periudha kohore e proceseve në të cilat përfshihen edhe nominimet dhe llogaritjet respektive të disbalancave të kryhet me interval kohor prej 1 ore deri më 31 mars 2023.

3. OST sh.a., të informojë periodikisht çdo 30 ditë për ecurinë e implementimit të ndryshimeve në platformën IT.

4. Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Inspektimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendrike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendrike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti